URDHËR
Nr. 741, datë 16.7.2026

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të shkronjës "b", të pikës 1 dhe pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminatëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panaire dhe grumbullime të tjera në qarkun Vlorë.
2. Ndalimin e lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuara nga ferma në fermë në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.
3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël dhe inventarizimin e tyre në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.
4. Forcimin e masave të biosigurisë.
5. Kafshët e llojit të imta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluara nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.
6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privat dhe shërbimit veterinar shtetëror.
7. Intensifikimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
8. Masat e sipërcituara nga pika 2 deri në pikën 6, zbatohen në territorin e:

Nr.	Njësia Administrative	Fshati
3 km		
1	Brataj	Lepenicë
2	Brataj	Gjorm
10 km		
3	Brataj	Velçë
4	Brataj	Malas
5	Brataj	Brataj
6	Brataj	Mesaplik
7	Hore-Vranisht	Tërbaç
8	Hore-Vranisht	Vranisht
9	Kotë	Gumenicë
10	Kotë	Vajzë
11	Sevaster	Ploçë
12	Orikum	Dukat Fshat

9. Zbatimin e masave të tjera të përmendura në urdhrin nr. 802, datë 9.10.2024, “Për miratimin e planit kombëtar të kontigjencës për sëmundjen e murtajës së ruminantëve të vegjël (PPR)”.

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla